



VENDIM
Nr.54 Datë 25.08.2010

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ELEKTRO LUBONJA” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.08.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELEKTRO LUBONJA” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ELEKTRO LUBONJA” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacionit finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “ELEKTRO LUBONJA” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec - Lubonjë” me fuqi 0.3 MW.
2. Afati i kohëzgjatjes së liçensës do të jetë 30 vjet.
3. Shoqëria të fillojë ushtrimin e aktivitetit për prodhimin e energjisë elektrike në përputhje me afatet e përcaktuara në Kontratën e Konçesionit.



-
4. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA